



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Nr. 4219/1 Prot.
Datë 27.6 2024

MINISTRIA E FINANCAVE
Nr. 9062/1 Prot.
Datë 11.7 2024

UDHËZIM
Nr. 18, datë 27.6 2024

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 7.3.2024 "PËR
KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024" dhe të pikës 5, të VKM nr. 130, datë 6.3.2024, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2024", ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 6, datë 7.3.2024 "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural", bëhen shtesa dhe ndryshimet si më poshtë vijon:


- Në kreun VI, "Kriteret specifike dhe dokumentacioni i nevojshëm për masat mbështetëse", bëhen ndryshimet si vijon:
 - në masat 1,2,3,4,5 dhe 7, nëndarja "ii", togfjalëshi "20 ditë kalendarike" zëvendësohet me togfjalëshin "datës 31 korrik 2024".
 - në masën 6, nëndarja "ii", togfjalëshi "15 ditë kalendarike" zëvendësohet me togfjalëshin "datës 31 korrik 2024".
- Në kreun VII, "Procedurat që do të ndiqet për përzgjedhjen, verifikimin dhe pagesat për masat mbështetëse me nr. 1-7", në pikën 4, bëhet ndryshimi si vijon:

Togfjalëshi "20 ditë kalendarike nga data e shpalljes së listës" zëvendësohet me togfjalëshin "31 korrik 2024..."

3. Në kreun VIII, "Kriteret, dokumentacioni dhe procedura për masën 8: mbështetje për naftën për punimet e mekanizuara në bujqësi- Aplikimi për mbështetje për naftën për bujqësinë", në pikën 13, shtohet paragrafi, me formulimin si vijon:
"Gjithashtu, të vlefshme do të konsiderohen edhe rastet kur dokumentat e sipërcituar nëshkruhen nga njëri prej anëtarëve të familjes bujqësore në gjendjen aktuale."

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL



MINISTRI I FINANCAVE

